


MANUAL PËR TRAJNUES

Trajnimi 1: Briefing të deputetëve për shfrytëzimin e analizave dhe raporteve nga institucionet.

Trajnimi 2: Briefing të deputetëve për shfrytëzimin e analizave dhe raporteve nga organizatat qytetare.

Autorë: Marko Pankovski dhe Misha Popoviq



„DEPUTETË TË INFORMUAR, INSTITUCIONE TË PËRGJEGJSHME“
fuqizimi i kapaciteteve të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit

Impresum

Titulli: Manual për trajnues „Deputetë të informuar, institucione të përgjegjshme“

Autorë: Marko Pankovski dhe Misha Popoviq

Botues: Instituti për Demokraci
„Societas Civilis“ – Shkup

Përkthim: Litra

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/manual-per-trajnues-deputete-te-informuar-institucione-te-pergjegjshme/>

Hyrje

Ky manual për trajnues është përpiluar me qëllim që të mundësojë një rreth më i gjerë trajnuesish nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, shoqëria civile dhe bashkësia akademike të përcjellin njohuri se si të dhënat e organizatave të shoqërisë civile aktive në luftën kundër korrupsionit të vijnë deri te deputetët. Trajnimi është dedikuar për asistentët e deputetëve dhe të punësuarve në Institutin Parlamentar pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve të tyre për përdorimin e analizave të shoqërisë civile gjatë njoftimit të deputetëve për luftën kundër korrupsionit.

Struktura dhe përmbajta programore e manualit janë përgatitur në bazën e eksperiencave të Institutit për Demokraci „Societas Civilis” – Shkup gjatë punës me të punësuar në administratën publike, Kuvend dhe sektorin publik në tërësi. Pjesa programore e këtij manuali është zhvilluar në kornizat e projektit Bisedime anti-korrupsion në Parlament të cilin IDSCS-ja e zbaton me mbështetjen e Fondacionit Kombëtar për Demokraci nga SHBA-ja (National Endowment for Democracy), dhe një nga trajnimet e këtij lloji u realizua me asistentë dhe deputetë dhe të punësuar në Institutin Parlamentar në mars të vitit 2020.

Përdorues të manualit

Manuali është dedikuar para së gjithash për trajnues në Kuvend, sektorin civil dhe bashkësinë akademike të cilët kanë njohuri nga fusha e anti-korrupsionit.

Përfitues të trajnimit

Trajnimi është parashikuar të realizohet me asistentë të përkohshëm dhe të përhershëm të deputetëve, si dhe të punësuar në Institutin Parlamentar pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i trajnimit

Qëllimi i trajnimit është mundësimi i rritjes së pjesëmarrjes së analizave të krijuara nga sektori civil në njoftimin të cilin e bëjnë asistentët pranë deputetëve për luftën kundër korrupsionit.

Materiale të nevojshme

Ambient i veçantë për punë, projektor, flip çart, të paktën 4 kompjuterë personal, internet, fletore për shënime.

Struktura dhe metodologjia e trajnimit

Trajnimi është strukturuar në tetë sesione në tre ditë pune, për grup prej **9 deri në 12 nxënës**. Kjo madhësi rekomandohet për të siguruar ndërveprim më të madh, mundësi për përfshirjen e të gjithë pjesëmarrësve, si dhe punë në tre ose katër grupe. Trajnimi mund të realizohet nga një ose dy trajnues dhe një ndihmës administrativ.

Të gjitha sesionet duhet të përfshijnë diskutim ndërveprues dhe të nxisin pjesëmarrjen aktive të të gjithë pjesëmarrësve gjatë gjithë sesioneve. Për shkak të volumit të informacioneve dhe kompleksitetit, pjesëmarrësit duhet të kenë mundësi të drejtojnë pyetje gjatë gjithë sesionit, në vend të një sesioni të veçantë për pyetje dhe përgjigje.

DITA 1

SESIONI 1:

Hyrje në luftën kundër korrupsionit

Sesioni hyrës ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë pjesëmarrësit njihen me qëllimet e trajnimit, konteksti në të cilin mbahet, kush e organizon dhe me mbështetjen e kujt, si dhe përfitimet që do të kenë pjesëmarrësit nga i njëjti. Në këtë sesion, trajnuesit prezantojnë veten dhe përvojën tyre profesionale me qëllim që t'ju njoftojnë pjesëmarrësve eksperiencën e tyre dhe autoritet për të realizuar trajnimin. Pas kësaj, pjesëmarrësit duhet të prezantohen dhe shkurtimisht në disa minuta të përshkruajnë vendin e tyre të punës në Parlament.

Në pjesën e dytë, trajnuesit nëpërmjet një diskutimi interaktiv punojnë me pjesëmarrësit për sqarimin e termit korrupsion, çfarë do të thotë ai, ku ndodh dhe kush preket nga korrupsioni. Në këtë sesion është e nevojshme të prezantohet Legjislacioni anti-korrupsion në vend¹ dhe institucionet e lidhura dhe kompetencat adekuate. Rekomandohet që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, kompetencat e tij, si dhe lidhjen e punës së Kuvendit dhe raportet vjetore.

Rekomandohet që trajnuesit në fillim t'ju japin hapësirë pjesëmarrësve të tregojnë vetë çfarë nënkuptojnë me termin korrupsion dhe të inkurajojnë diskutimin e ndërmjet tyre, dhe pastaj t'i adresojnë pikëpamjet individuale të pjesëmarrësve dhe në përfundim t'i përcjellin definicionet e pranuar në përgjithësi shkencore dhe juridike për korrupsionin. E rëndësishme është të bëhet në një mënyrë sa më të thjeshtë me qëllim që të sigurohet se të gjithë pjesëmarrësit kuptojnë mirë çfarë është korrupsioni që është parakusht i punës efektive në sesionet e mëtejshme.

¹ Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave, Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve, Ligji për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik, Kodi Penal dhe Ligji për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

SESIONI 2:

Niveli i analizës së korrupsionit

3Gjatë kohës së këtij sesioni ka një qasje gjithnjë e më thelbësore për korrupsionin si fenomen. Gjatë kohës së trajnimit, është veçanërisht e rëndësishme trajnuesit të bëjnë lidhjen e vazhdueshme të niveleve të ndryshme të anti-korrupsionit me kontekstin juridik, institucional dhe shoqëror maqedonas.

Sesioni duhet të përfshijë mënyra të ndryshme të matjes së korrupsionit, nëpërmjet:

- Perceptimeve (matet eksperiencia dhe pritshmëria);
- Eksperiencës (matet eksperiencia dhe përfshirja në korrupsion);
- Vlerave (maten vlerat shoqërore dhe sjellja joformale);
- Rreziqeve (matet ngjashmëria e gjendjeve të caktuara me rastet e mëparshme ku ka pasur korrupsion të konfirmuar).

Pas prezantimit të mënyrave të matjes së korrupsionit, është e nevojshme të prezantohen mënyrat e matjes të këtyre indikatorëve, përkatësisht përdorimit të:

- të dhënave materiale (të dhëna nga institucionet, raste gjyqësore);
- hulumtim i opinionit publik dhe etnografia (qytetarë dhe ekspertë).

Rekomandohet që ky sesion të mos zgjasë më shumë se një orë e pesëmbëdhjetë minuta me qëllim mbajtjen e vëmendjes së pjesëmarrësve duke pasur parasysh volumin e informacioneve të reja, si dhe atë që sesioni mbahet gjatë fundit të ditës së punës.

DITA 2

SESIONI 3:

Si mund të informohen deputetët

Në fjalimet dhe argumentimet, deputetët shumë rrallë shfrytëzojnë fakte nga raportet e shoqërisë civile. Edhe përpos volumit dhe shumëllojshmërisë së raporteve dhe analizave të përgatitura nga shoqëria civile, megjithatë ato vështirë e gjejnë rrugën e vet deri te deputetët. Prandaj është e nevojshme të tregohet vlera e shtuar e këtyre analizave dhe vendet ku mund t'i gjejnë.

Ky sesion mund të fillojë me diskutime rreth burimeve që shfrytëzojnë asistentët, si arrijnë deri ata dhe a kanë përdorur deri tani gjetjet nga shoqëria civile. Në këtë pjesë është e rëndësishme të arrihet në njohuri se cilat janë mënyrat me të cilat asistentët vijnë deri te informacionet me qëllim që pastaj të diskutohen vendet në të cilat mund të arrihet deri te analizat e nevojshme dhe informacionet.

Në lidhje me shoqërinë civile, mund të bisedohet për organizata të cilat janë aktive për sa i përket temës së luftës kundër korrupsionit, që përgatisin raporte të rregullta dhe ofrojnë zgjidhje në fusha të caktuara.

Për shkak të shoqërisë civile dhe volumit të analizave, rekomandohet që të prezantohen baza të të dhënave me fakte të shoqërisë civile që do të shërbejnë si një stacion gjatë rrugës për qasje në burimet e tjera.

Qendra e burimeve VNR

Një shembull i tillë është qendra e burimeve VNR në hije (www.pvr.mk) që përfaqëson një platformë-ueb interaktive e cila integron të dhëna përmbledhëse për pothuajse 800 publikime të botuara nga shoqëritë civile me qëllim sigurimin e hulumtimeve që do të jenë me dobi për krijuesit e politikave, vendimmarrësit dhe shoqërinë civile të cilat kanë interes në procesin e krijimit të politikave të bazuara në dëshmi.

Komponenti kryesor i qendrës së burimeve është baza me publikime e cila është organizuar sipas fushave tematike dhe fjalëve kyçe të përcaktuara më parë. Për secilin nga publikimet janë theksuar 17 kategori të informacioneve nga të cilat janë tërhequr tri fakte të shkurtra dhe tri rekomandime të shkurtra, drejt të cilave janë orientuar të njëjtat, si dhe lidhje me ueb-faqen ku është bashkëngjitur publikimi.²

Baza e rekomandimeve për luftën kundër korrupsionit

Burim plotësues që mund të jetë i dobishëm për asistentët dhe deputetët është baza e fakteve dhe rekomandimeve për luftën kundër korrupsionit të përbëra nga rreth 80 analiza të botuara nga institucione ndërkombëtare, organe të pavarura dhe shoqëria civile. Nëse asistentët janë të interesuar për një shqyrtim më të thellë, baza ofron lidhje me të gjitha analizat të cilat të çojnë deri te ueb-faqet e botuesve.³

² Qendra e burimeve ПБР në hije. Instituti për Demokraci „Societas Civilis” – Shkup dhe Qendra për Analiza Ekonomike. Në dispozicion në: <https://pvr.mk/>

³ Baza e rekomandimeve për luftën kundër korrupsionit. Instituti për Demokraci „Societas Civilis” – Shkup. Në dispozicion në: <https://idscs.org.mk/mk/2020/06/17/база-на-публикации-со-препораки-за-бор/>

SESIONI 4:

Mjete për përmbledhjen e raporteve

Pjesa kyçe e punës së deputetëve është që të kryejnë mbikëqyrje efikase dhe efektive mbi punën e institucioneve. Volumi i informacioneve që arrijnë deri te deputetët vështirësojnë një shikimi të qartë mbi punën e institucioneve. Struktura e raporteve nga institucionet nuk ndjekin të njëjtën strukturë gjë e cila nuk mundëson deputetët të kenë një set të përcaktuar dhe cilësi të informacioneve deri te deputetët e çdo institucioni.

Në këtë sesion me pjesëmarrësit diskutohen sfidat në njoftimin nga ana e institucioneve. Pastaj në mënyrë të hollësishme prezantohet dhe bisedohet rreth Modelit të standardizuar për raportin vjetor për organe të pavarura të cilat përgjigjen para Kuvendit. Ky model është përgatitur nga ana e Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, misioni i OSBE-së në Shkup, Instituti për Demokraci „Societas Civilis“ – Shkup dhe 12 agjenci të pavarura dhe trupa rregullatorë të cilat kanë si obligim të njoftojnë Komisionin.⁴ Modeli përmban format të përcaktuar paraprakisht prej 10 pikësh dhe përfaqëson formën e raportit vjetor të cilin institucionet e pavarura dhe rregulluese kanë si obligim të njoftojnë parlamentin për punën e vet. Përveç kësaj siguron një set të caktuar të informacioneve të cilat duhet të përmbajnë, i njëjti jep mundësi edhe për krahasimin ndërmjet institucioneve të ndryshme që mund të lehtësojë në mënyrë plotësuese punën e asistentëve gjatë përgatitjes së raporteve për deputetët. Nëse institucionet përdorin format të ndryshëm, asistentët mund të përmbledhin raportet në këtë model që pastaj do t'u shërbente gjatë përgatitjes së memorandumit për politika dhe forma të tjera të shkurtra për njoftim.

⁴ Model i standardizuar i promovuar për raportin vjetor për trupa të pavarur që përgjigjen para Kuvendit. Instituti për Demokraci „Societas Civilis“ – Shkup, 2 mars 2018. Në dispozicion në: <<https://idscs.org.mk/mk/2018/03/02/промовиран-стандардизиран-урнек-за-г/>>

SESIONI 5 dhe 6 :

Shkrimi dhe përfaqësimi te vendimmarrësit

Për shkak të volumit të informacioneve sesioni ndahet në dy pjesë. Ky sesion është kyç për të gjithë trajnimin dhe qëllimet drejt transformimit të informacioneve në një format të shkurtër strukturor i cili do të jetë i pranueshëm për deputetët.

Në fillim është e rëndësishme të kuptohet çfarë formatesh njoftimi përdorin asistentët kur punojnë me deputetët dhe të diskutohen përparësitë e tyre dhe mangësitë potenciale.

Pjesa e mbetur nga sesionet duhet të përfshijë teknika praktike për shkrimin e formave të shkurtra dhe përfaqësim te vendimmarrësit:

- Identifikimi i publikut;
- Niveli i abstraksionit;
- Dallime në formate (studim përkundër studimit të shkurtër të politikave – policy brief) dhe dallime në kompleksitetin e gjuhës së përdorur;
- Memorandum përkundër brif;
- Konstruksioni i argumentit;
- Strukturimi i tekstit;
- Struktura e paragrafit;
- Qartësi shkrimi;

Pas përfundimit të kësaj pjese të sesionit, pjesëmarrësit ndahen sipas grupeve dhe ngarkohen të zgjedhin temë mbi të cilën duan të hulumtojnë dhe faktet hulumtuese t'i kopjojnë në një memorandum politik prej një faqeje. Pjesëmarrësit punojnë deri në fund të sesionit, ndërsa prezantimet bëhen në sesionin tjetër.

DITA 3

SESIONI 7: Prezantimi

Në këtë sesion, pjesëmarrësit prezantojnë dokumentet e përgatitura para pjesëmarrësve të tjerë. Pas prezantimit pjesëmarrësit, dhe pastaj trajnuesit japin komente për strukturën e tekstit, mënyrën në të cilën është mbuluar tema dhe publiku në mesazhet përfaqësuese. Është e rëndësishme që në këtë pjesë të shmangen debatet tematike, ndërsa fokusi të jetë në strukturën.

Pas prezantimeve, trajnuesit pyesin pjesëmarrësit për eksperiencat e tyre në punën e drejtpërdrejtë me deputetët gjatë një kohe të kufizuar t'i paraqesin argumentet e tyre. Me qëllim që të ushtrohet struktura dhe prioriteti i argumenteve, pjesëmarrësit kalojnë drejt simulimit të një takimi me deputet në ashensor, ku kanë në dispozicion vetëm 30 sekonda për të prezantuar mesazhet e veta. Në bazë të memorandumëve të përpiluara, të gjithë pjesëmarrësit duhet të përgatisin një fjalim prej 30 sekondash, dhe pastaj vijojnë komentet e pjesëmarrësve dhe trajnuesve.

SESIONI 8: Vlerësimi

Vlerësimi është një element e i rëndësishëm i çdo trajnimi. Duke pasur parasysh specifikën në të cilën punojnë asistentët e deputetëve, është e rëndësishme që ata të kenë mundësi të tregojnë si mund të përmirësohet programi i trajnimit, por edhe të përshtatet me realitetin në të cilin ata punojnë. Duke pasur parasysh se trajnimi është i dedikuar që të vazhdojë në kontinuitet, njohuritë që kanë asistentët e deputetëve nga kontakti i tyre ditore mund të kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme drejt përmirësimit të trajnimit tjetër.

Rekomandohen dy tipa vlerësimi. Interaktiv dhe anonim.

Vlerësim interaktiv

Është e rëndësishme që vlerësimi i drejtpërdrejtë të zhvillohet në një format të lirë dhe joformal që pjesëmarrësit të jenë të lirë të ndajnë qëndrimet e tyre. Trajnuesit është e rëndësishme të theksojnë se vlerësimi bëhet me qëllim që të përmirësohen trajnimet e ardhshme dhe të inkurajojnë pjesëmarrësit të flasin lirisht dhe të japin vërejtje konstruktive për sa i përket aspektit programor dhe logjistik të trajnimit. Ideale do të jetë që diskutimi të zhvillohet lirisht, por trajnuesit është e rëndësishme të sigurojnë që diskutimi të mbulojë çështjet e mëposhtme:

- Përfshirja programore të trajnimit;
- Shkathësi të fituara;
- Niveli i diskutimit interaktiv;
- Bashkëpunimi me pjesëmarrësit e tjerë;⁵
- Rëndësia praktike e trajnimit (me shembuj nga puna e tyre);
- Trajnuesit dhe metodologjia e tyre;
- Intensiteti;
- Aspekte logjistike si kushte dhe materiale për punë, akomodim, transport.

Për një diskutim të mirë, është e rëndësishme që trajnuesi që do të lehtësojë diskutimin të mos mbajë shënime por t'i kushtohet plotësisht diskutimit. Shënime mund të mbajë anëtari i dytë i ekipit.

Vlerësim anonim

Pas përfundimit të eventit, trajnuesit duhet të ndajnë formën për vlerësimin anonim të trajnimit e cila duhet të përmbajë të gjitha aspektet e vlerësimit të drejtpërdrejtë. Vlerësimi mund të ndahet në formë të shkruar ose nëpërmjet një platforme on-line (Google Forms, Lime Survey, SurveyMonkey). Nëse ekziston mundësi, platformat on-line janë forma e rekomanduar në relacion me format e shkruara sepse mundësojnë përgatitjen më të lehtë të të dhënave, si dhe mundësi që vlerësimi të plotësohet pas përfundimit të trajnimit.

⁵ Kjo pjesë është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh që pjesëmarrësit shpesh vijnë nga parti të ndryshme politike me pikëpamje të kundërta

Pas trajnit

Menjëherë pas trajnimit, trajnuesit duhet të ndajnë me pjesëmarrësit të gjitha materialet sipas të cilave është punuar. Kjo do të mundësojë që pjesëmarrësit e interesuar përsëri të rikthehen te disa materiale, si dhe t'i përdorin gjatë punës së tyre dhe t'i prezantojnë në mënyrë ideale para deputetëve.

PËR PROJEKTIN

Manuali është përgatitur në kornizat e projektit Bisedime anti-korrupsion në Parlament. Projekti i orientuar drejt rolit mbikëqyrës të deputetëve në fushën e luftës kundër korrupsionit. Projekti është financuar nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci nga SHBA-ja.

ANEKS: propozim AGJENDA

Dita e parë		Dita e dytë	
13:30 - 14:30	<p>SESIONI 1</p> <p>Hyrje në luftën kundër korrupsionit</p> <p>Pritshmëri të pjesëmarrësve</p> <p>Pasqyrë teorike dhe implikime praktike në luftën kundër korrupsionit</p>	10:00 - 11:00	<p>SESIONI 3</p> <p>Si deri te deputetë të informuar</p> <p>Pasqyrë e raporteve të shoqërisë civile</p> <p>Praktika të mira për njoftim</p>
14:30 - 14:45	Pauzë për kafe	11:00 - 11:15	Pauzë për kafe
14:45 - 16:00	<p>SESIONI 2</p> <p>Nivele të analizës së korrupsionit</p>	11:15 - 12:15	<p>SESIONI 4</p> <p>Mjete për përmbledhjen e Memorandum për politika</p> <p>Dokumente të shkurtra për politika publike</p>



12:15 - 13:30	Dreka
13:30 - 14:30	<p>SESIONI 5</p> <p>Përpilimi i memorandumeve për politika (pjesa 1)</p> <p>Përpilimi i memorandumeve për politika për deputetët</p> <p>(Punë në grupe)</p>
14:30 - 14:45	Pauzë për kafe
14:45 - 16:00	<p>SESIONI 6</p> <p>Përpilimi i memorandumeve për politika (pjesa 2)</p> <p>Përpilimi i memorandumeve për politika për deputetët</p> <p>(Punë në grupe)</p>

Dita e tretë	
08:00 - 10:00	Mëngjesi
10:00 - 11:00	<p>SESIONI 7 PREZANTIMI</p> <p>Prezantimi i draft-memorandumeve për politika</p> <p>Komente nga pjesëmarrësit dhe trajnuesit</p>
11:00 - 11:15	Pauzë për kafe
10:00 - 11:00	<p>SESIONI 8 SESIONI PËRFUNDIMTAR</p> <p>Hapa të ardhshëm</p> <p>Vlerësimi</p>

INFORMACION MBI IDSCS

IDSCS është think tank - organizatë civile që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Maqedonisë. IDSCS ka për mision ndihmën e angazhimit qytetar në vendimmarrje dhe për të forcuar kulturën pjesëmarrëse politike. Duke zhvilluar vlerat liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën midis diversitetit.

Informatat kontaktuese për IDSCS

-

Adresë: Str. Miroslav Krlezha No.

52/1 /2, 1000 Shkup

Telefoni / Fax: +389 2 3094760

E-Mail: contact@idscs.org.mk

PËR AUTORIN


Marko Pankovski është studiues i vjetër në Qendrën pranë Institutit për Menaxhimin e Mirë pranë Institutit për Demokraci „Societas Civilis” – Shkup dhe Rethink. CEE Fellow bo German Marshall Fund of the United States.

Misha Popoviq është një studiues i vjetër dhe koordinatori programor i Qendrës për Menaxhim më të Mirë pranë IDSCS-së. Anëtar i Këshillit të Platformës së Shoqërive Civile për luftën kundër korrupsionit.

LINK

Ky publikim është në dispozicion në:

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/maqedonia-e-veriut-ne-nato-shans-per-rritjen-e-rolit-mbibeqyres-te-kuvendit/>



„DEPUTETË TË INFORMUAR, INSTITUCIONE TË PËRGJEGJSHME“
fuqizimi i kapaciteteve të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit